



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit

01 Nr 020/09-3997 dt. 22/09/ 2020

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenin 17 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nenin 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

**Për formimin e Komisionit për hartimin e paramasave dhe parallogarive për projektin:
Mirëmbajtja dhe Pastrimi i objektit të Komunës dhe të dy Shkollave të Mesme SHMP
“Fehmi Lladrovci” dhe SHML “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”**

- I. Formohet Komisioni për hartimin e paramasave dhe parallogarive për projektin: Mirëmbajtja dhe Pastrimi i objektit të Komunës si dhe të dy shkollave të mesme SHMP “Fehmi Lladrovci” dhe SHML “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, në këtë përbërje:
 1. Sami Heta, (kryetar),
 2. Sylejman Hajdari, (anëtar),
 3. Shaban Dobra, (anëtar).
- II. Ky komision ka për obligim që të bëjë hartimin e paramasave dhe parallogarive për projektin: Mirëmbajtja dhe Pastrimi i objektit të Komunës si dhe të dy shkollave të mesme SHMP “Fehmi Lladrovci” dhe SHML “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” dhe të njëjtat të i dorëzojnë në Drejtorinë për Administratë të Përgjithshme, respektivisht në Zyrën e Prokurimit për shpallje.

- III. Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.
- IV. Komisioni i lartcekur punën e tyre duhet ta kryej me profesionalizëm të lartë dhe përkushtim, dhe të njëjtën ta përfundoj në afat sa me të shkurtër.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.



Kryetari i Komunës
[Signature]
Ramiz Mladrovci

Iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Anëtareve të Komisionit;
- DPA-së;
- DKA-së;
- Arkivit të Komunës së Drenasit.